



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.2 , datë 29.07.2021

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJITIK”,
SHOQËRISË “JOVA COMPANY” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjitik”, shoqërisë “Jova Company” sh.p.k., me vendndodhje, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë, baseni ujor Shkumbin, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC NIÇA

Vepra e marrjes nr.1

- X=539834
- Y=4521329

- Z=1.780 m.m.n.d

Vepra e marrjes nr.2

- X=540002
- Y=4521039
- Z=1.784 m.m.n.d

Vepra e marrjes nr.3

- X=539834
- Y=4521329
- Z=1.784 m.m.n.d

Godina e Centralit

- X=543467
- Y=4521553
- Z=1.372 m.m.n.d
- Qmes=0.385 m³/s
- Qllog=0.385 m³/s
- Qeko=0.0099 m³/s
- Fuqia e instaluar N=1.300 Kw
- Energjia Vjetore E=2.651.080 Kw/vit

3. Zbatimi i kësaj kontrate nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

Spiro MALIQI

